

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Do të më vrasin bandat"/ Shqiptari fiton të drejtën e anonimatit në Angli, por poston video nga gjykata
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/do-te-me-vrasin-bandat-shqiptari-fiton-te-drejte-e-anonimatit-ne-ang-i106403
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 11:14:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 11:07:16 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	57125f6e3b4ef8c4a3510f9f147bdf7304d9dcce3e52f9a78f4907e3c0ae8926
TEKSTI	9cac06a803ff837604a3950d8c5c036dc3ce873304cf945647180016ee3ecc06
PAMJA	27e8f9bfff3b4f1c744b8dc7f3872bec7349ec836da84bffcfd18313f8f6f7f6db

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e98dc6558ce92ea5a6b4c9de1539b712f20161d7a480d09e0ea71835d325e60c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b4355a68894c65a63b1e90d1f962746a91a9c18b00f6b0772c3894db0f3539f0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e98dc6558ce92ea5a6b4c9de1539b712f20161d7a480d09e0ea71835d325e60c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

çështjes: Më janë shkelur

Kushtetuese, ku i ka kërku...

Gysit. Harta e PS si

ne Komisionin e Ligjeve

in dhe Vlora Hysenin,

akuzat kryeministrin Edi Rama për mungesë

publikojnë numrat e

nga grupi i hakerëve "Homeland Justice" të

negociatave deri në 2027

AKTUALITET

"Do të më vrasin bandat"/ Shqiptari fiton të drejtën e anonimatit në Angli, por poston video nga gjykata

Piranjat Përditësimi i fundit 28 Shtator 2026, 13:07



Një gjyqtar britanik i dha anonimitet një shtetasi shqiptar, i dënuar disa herë për vjedhje dhe që përballlet me dëbimin e pestë nga Mbretëria e Bashkuar. Kjo pasi ai pretendoi se rrezikohej nga një bandë kriminale shqiptare. Shqiptari, i cili është në të 30-at dhe ka një fëmijë në Britani, ka apeluar kundër urdhrin të dëbimit dhe ka kërkuar azil, duke pretenduar se kthimi në Shqipëri do të vinte jetën e tij në rrezik. [Mediat](#) shkruajnë se në ditën e seancës ai publikoi në rrjetet sociale një video që dukej se ishte filmuar brenda gjykatës.

Gjatë seancës, shqiptari tha se ishte detyruar të largohej drejt Britanisë pasi një bandë kriminale e kishte detyruar të kryente vjedhje dhe më pas e kishte kërcënuar atë dhe familjen e tij. Ai pretendoi se ishte rikthyer ilegalisht në Britani pas dëbimeve të mëparshme sepse ndihej i rrezikuar në Shqipëri dhe në vende të tjera evropiane.

Përfaqësuesja e Home Office, Khdeej Khan vuri në dyshim pretendimet e tij, duke theksuar se nuk kishte prova që ai ishte në rrezik dhe se nuk kishte raportuar kërcënimet në polici. Ajo përmendi gjithashtu aktivitetin e tij në rrjetet sociale, ku shfaqej në makina luksoze dhe në ambiente nate. Avokati i tij, Eric Frupp, kërkoi që identiteti i klientit të mbetej i fshehtë për shkak të pretendimit për azil, kërkesë që u pranua nga gjyqtari Ravinder Bagral. Vendimi përfundimtar për çështjen e dëbimit dhe azilit pritet ende.

Një gjyqtar britanik i dha anonimitet një hajduti serial që po lufton kundër dëbimit të tij të pestë, duke pretenduar se është në rrezik nga një bandë kriminale shqiptare – por më pas vetë i dënuari publikoi një video nga gjykata. Personi është dënua për disa vepra penale në Mbretërinë e Bashkuar dhe është dëbuar vazhdimisht nga Home Office, përpara se të rikthehej fshehurazi në vend. Tani ai ka apeluar kundër urdhrin të fundit të dëbimit dhe ka kërkuar azil, me arsyetimin se jeta e tij mund të jetë në rrezik nëse kthehet në Shqipëri.

Gjatë një seance javën e kaluar në Gjykatën e Emigracionit 'Taylor House', në qendër të Londrës, shqiptari pretendoi se ishte detyruar të largohej drejt Britanisë së Madhe sepse ishte "shumë e lehtë" që armiqet e tij ta gjejmë në vende të tjera të Evropës. Personi, i cili është në të 30-at dhe ka një fëmijë në Britani me një partnere të ndarë prej tij, pretendoi gjithashtu se shëndeti i tij mendor ishte dëmtuar si pasojë e raportimeve të mëparshme mediatike për çështjen e tij.

Megjithatë, ditën e seancës, ai publikoi në rrjetet sociale një video që dukej se e tregonte të ulur në një zonë pritjeje në gjykatë, të cilën e identifikoi me emër në përshkrimin e videos. Përveçse zbulonte vendndodhjen e tij, pamjet duket se shkelin edhe ndalimin për fotografimin dhe filmimin brenda ndërtesave të gjykatave. Kushdo që konstatohet se ka shkelur këto rregulla mund të ndiqet penalisht për shpërfillje të gjykatës dhe mund të përballlet me një dënim deri në dy vjet burg. Përfaqësuesi i tij, Eric Frupp, i tha gjykatës se ai kishte të drejtë të mbetej anonim, pasi po kërkonte azil mbi bazën e nevojës për mbrojtje.

Kjo kërkesë u pranua nga gjyqtari Ravinder Bagral. Medias nuk iu dha mundësia ta kundërshtonte urdhrin për anonimitet gjatë seancës, megjithëse Daily Mail më pas ka kërkuar anulimin e tij. Një përfaqësues i gjykatës konfirmoi pas seancës së 15 shtatorit se kërkesa ishte marrë dhe ishte në shqyrtim. Alan Mendoza, Drejtor Ekzekutiv i Henry Jackson Society, kritikoi vendimin për t'ia fshehur identitetin publikut.

"Drejtësia e hapur ekziston në mënyrë që publiku të mund të shohë se si merren vendimet në emër të tij. Dhënia e anonimitetit një kriminelin profesionist që filmon veten në gjykatë për rrjetet sociale, ndërsa përballlet me dëbimin e tij të pestë, për shkak të një kërcënimi që nuk e ka raportuar kurrë në polici, e tall këtë parim. Publiku meriton më shumë."

Khdeej Khan, që përfaqësonte Home Office, tha se burri kishte kryer një seri vjedhjesh gjatë kohës që jetonte në Britaninë e Madhe, përfshirë edhe pas secilës prej katër rasteve kur ishte rikthyer ilegalisht në Mbretërinë e Bashkuar pasi ishte dëbuar. Ajo e pyeti në gjykatë: "A e pranoi se keni kryer vazhdimisht krime të rënda në Mbretërinë e Bashkuar, të lidhura me vjedhje? A e pranoi se keni shkelur vazhdimisht liqet britanike të kufirit dhe se keni shkelur një urdhrë dëbimi katër herë?" Burri pranoi se veprat e tij penale ishin "shumë serioze", por pretendoi se ishte "detyruar" të

kthehej ilegalisht në Britani për shkak të frikës për sigurinë e tij.

Ai i tha gjykatës se kishte mbërritur për herë të parë në Britani në moshën 13-vjeçare, përpara se të binte në duart e një bande të fuqishme kriminale shqiptare që e detyronte të kryente vjedhje. Ai pretendoi se, kur më vonë u përpoq të largohej nga banda, si ai ashtu edhe familja e tij u bënë objektiva. Sa herë që dëbohej në Shqipëri, ai tha se mësonte se anëtarët e bandës po e kërkonin dhe largoheshin përsëri brenda dy ose tre javësh. Fillimisht, tha ai, u përpoq të vendosej diku tjetër në Evropë, por edhe atje ata zbuluan vendndodhjen e tij. Ai tha se banda fillimisht ishte përpjekur ta gurmonte në Britani, por se për më shumë se një vit nuk kishte pasur probleme këtu dhe ai besonte se ata ishin dorëzuar, duke e bërë Britaninë e Madhe të vetmin vend ku ndihej i sigurt.

Ai i tha gjykatës: “Banda ka pasur kontakte në Shqipëri. Më rrëmbyen dhe një herë më vunë thikën në qafë. Kisha fat që shpëtova. U përpoqa të qëndroja në Evropë, por në Evropë ishte shumë e lehtë të më gjenin, kështu që më duhej të vija këtu.” Ai i tha gjithashtu gjykatës se ishte tepër e rrezikshme të kthehej, sepse familja e tij ishte përfshirë në një gjakmarrje shqiptare, gjatë së cilës xhaxhai i tij ishte qëlluar dy vjet më parë, por “policia lokale e korruptuar” e kishte “mbyllur çështjen”. Zonja Khan tha se nuk kishte prova që mbështesnin pretendimet e tij se ishte në rrezik në Shqipëri dhe vuri në dukje se ai nuk kishte raportuar asnjë kërcënim në polici, as në Shqipëri dhe as në Britani.

Ai u përgjigj: “Arsyeja pse nuk raportova asgjë në Shqipëri është sepse policia është e korruptuar dhe banda është shumë e fuqishme dhe ka lidhje me policinë atje.” Zonja Khan vuri gjithashtu në dukje përdorimin e shpeshtë të rrjeteve sociale nga burri – përfshirë fotografi të rregullta ku shfaqej në makina luksoze dhe duke pirë në klube nate – dhe pyeti se përse ai do të tërhiqte vazhdimisht vëmendjen ndaj vetes në internet nëse vërtet kishte frikë nga një bandë. Në përgjigje, ai pretendoi se “ndihej i sigurt” në Britani, por pranoi se postimet mund të shiheshin kudo në botë. Çështja u shty në pritje të vendimit të gjyqtarit Bagral.

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 28 Shtator12:58

[Laert Haxhia i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, kërkon rigjykim të çështjes: Më janë shkelur të drejtat](#)

I dënuari me burgim të përjetshëm Laert Haxhia i ka drejtuar një kërkesë Gjykatës Kushtetuese, ku i ka kërku...

AKTUALITET 28 Shtator12:24

[“Armand Duka jam, më duhen 100 mijë euro”/ Tentuan të zhvasnin 64-vjeçarin, arrestohen dy të rinj në Tiranë! \(Emrat\)](#)

Dy të rinj janë vënë në pranga nga Policia e Tiranës, pasi përmes mashtimit në rrjetet sociale, tentuan të zhvas...

AKTUALITET 28 Shtator12:17

[Ekspteri i sigurisë kibernetike: Hakerat e “Homeland Justice” publikojnë numrat e agjentëve të SHISH](#)

Ekspteri i sigurisë kibernetike Besmir Semanaj ka reaguar pas publikimit nga grupi i hackerëve “Homeland Justice” të materialeve q&e...

Nga Xhuljan Ferzaj AKTUALITET 28 Shtator11:13

[VIDEO/ Denoncimi i banorëve: Arapaj mbetet pa ujë prej 1 muaji e gjysmë, ndërsa uji derdhet kot në kanalet e ndotura](#)

Banorët e fshatit Arapaj i janë drejtuar redaksisë së Piranjat News me një denoncim të shoqëruar me video dhe foto, ku treg...

AKTUALITET 28 Shtator11:05

[Shkrirja me Korçën/ Këshilli bashkiak i Maliqit voton kundër bashkimit, vetëm 1 votë pro](#)

Këshilli Bashkiak i Maliqit ka zhvilluar mbledhjen e radhës, ku në rendin e ditës ishte miratimi i mendimit zyrtar lidhur me procesin e ri...

AKTUALITET 28 Shtator10:34

[Shpërdanin drogë pranë shkollave, detaje nga operacioni në Tiranë: Si vepronin 8 grupet dhe bashkëpunimi mes tyre!](#)

Detaje të reja dalin nga operacioni antidrogë i zhvilluar në Tiranë, për goditjen e rrjetit që shpërndante lëndë ...

AKTUALITET 28 Shtator10:28

[Tre operacione në Tropojë e Kukës, arrestohen tre persona për armëmbajtje, drogë dhe vjedhje](#)

Tre persona janë vënë në pranga këtë të hënë, pas tre operacioneve të ndryshme të zhvilluara në Tr...

AKTUALITET 28 Shtator10:16

[Një murale për turistin e vrarë barbarisht në Shqipëri: Lot, zemërim dhe mall për Miltonin](#)

Nga Gregory Leclerc, NICE MATIN Mallëngjimi i thellë, saudade, ndihej këtë të diel në fushën sportive Thérès...

AKTUALITET 28 Shtator09:55

[Shoqata e Gjyqtarëve refuzon ftesën e Ramës për konsultim për pagat: Presim vendimin e ‘Kushtetueses’](#)

Shoqata e Gjyqtarëve të Shqipërisë ka refuzuar ftesën e kryeministrit Rama për të marrë pjesë në tryezë...

AKTUALITET 28 Shtator09:34

[Një klikim, mijëra lekë: Si po bien shqiptarët në grepin e ‘mashtimit kompjuterik’](#)

Gjithçka nisi nga një mesazh në telefon. Gentjana Driza ishte në pritje të një porosisë nga TEMU më 23 maj, kur mori një&e...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 27 Shtator

[I martuar me një grua ruse, si u kap gafil elba...](#)

Detaje të reja kanë dalë nga operacioni, për kapjen në Rusi të Salvatore alias Shpëtim Aliut në Federatën Ruse, ku ...

BOTA 27 Shtator

[“Kam vrarë vetëm 9”/ Njihuni me ‘engjëllin e vd...](#)

Ajo është infermierja vrasëse që u bë famëkeqe shumë kohë përpara se Lucy Letby të dënohej me burg. Bever...

AKTUALITET 27 Shtator

[Atentati në Athinë/ Ja çfarë i tha Denis Luli k...](#)

Sipas informacioneve të reja, katër autorët mbërritën në lokal me një automjet të vjedhur të enjten e kaluar në...

INVESTIGIME 26 Shtator 13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.